



Datë: 20.05.2025
Numër Protokolli: 4660/2025

A.nr.556/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.556/2025, të datës 26.03.2025 të parashtruar nga ankuesi E.U, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat Shkodran Manaj nga Fushë Kosova, më objekt ankimor” *kundërshtim i transferimit për shkak të ristrukturimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 20.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.556/2025, e datës 26.03.2025, e parashtruar nga ankuesi E.U, ashtu që, **anulohen** pika I dhe nën pika 2 dhe 3 e pikës II të Raportit më numër protokolli 171, të datës 27.02.2025, të Komisionit të Ristrukturimit në Ministrinë e Shëndetësisë si dhe çdo veprim tjetër administrativ që rrjedhë nga pjesa e anuluar e Raportit të datës 27.02.2025, ndërsa, çështja kthehet në **rishqyrtim dhe rivlerësim** të organi i njëjtë.

II. Detyrohet Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Shëndetësisë, që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë rivlerësim të procesit të ristrukturimit lidhur me pozitën zyrtar të lartë të prokurimit, duke vepruar në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetim të këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarr në zbatim të vendimit të Këshillit.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil E.U (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), më datë 26.03.2025, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.R.MSH 15/2024/2, të datës 28.02.2025, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.01.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 04.04.2025, ka përcjell dokumentacionin referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të LPPA-së, ka administruar këto prova: Ankesën me nr. protokolli 2019/2025 të datës 26.03.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 13.03.2025; Raportin përfundimtar të Komisionit të Ristrukturimit i datës 04.11.2025; Vendimin me Nr. R. MSH 15/2024 i datës 05.11.2024; Plotësim/ndrushmin e raportit të Komisionit të Ristrukturimit i datës 27.02.2025; Vendimin Nr.R.MSH 15/2024/2 të datës 28.02.2025 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB; Vendimin e datës 26.09.2021; Certifikatën e trajnimit për periudhën 25-27.2021; Certifikatë trajnimi e datës 26.10.2019; Certifikatë trajnimi për periudhën 16-19.11.2018; Certifikatën trajnimi e datës 06.07.2019; Certifikatës Themelore profesionale e prokurimit Nr. 480; Certifikatën trajnimi për periudhën 25-28.11.2010; Certifikatën e datës 07.07.2011; Certifikatë trajnimi tetor 2014; Certifikatë e datës 25.02.2017; Certifikatë e Avancuar profesionale për prokurim Nr. 542; Certifikatat e lëshuara nga USAID 2022; Certifikatën e datës 03.11.2023; Emailin e datës 23.09.2024 nga H.S për B.B; A.Th, E.U dhe E.Sh; Emailin e ankuesit për H.S; Emailin e datës 25.03.2025 nga Sh.M për A.M; Emailin e datës 24.03.2025 nga A.M për Sh.M; Emailin e datës 24.03.2025, 20.03.2025, 19.03.2025 nga Sh.M për A.M; Emailin e datës 21.03.2025, 19.03.2025, 18.03.2025 nga A.M për Sh.M; Emailin e datës 18.03.2025 dhe 14.03.2025 nga Sh.M për H.S; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 01.04.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 04.04.2025; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit i datës 03.05.2017 për ankuesin Akt Emërimit e datës 08.05.2012 për ankuesin; Vendimin e datës 23.08.2024 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit; Vendimin e datës 10.10.2024 për shtyrje të afatit për vende për transferim të nëpunësve civil në MSH; Dosjen e nëpunësit A.Th. me 30 faqe; Dosjen e nëpunësit Besim Bajraktari me 26 faqe; Dosjen e ankuesit me 24 faqe; Dosjen e nëpunësit E.G. me 39 faqe; Vendimin me numër protokolli 3034/2025 të datës 06.05.2025 për shtyrje të afatit për vendosje të ankesës së ankuesit; Vendimin me Nr. Prot: 05-921 të datës 01.03.2011 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSH-së; Vendimin A 02 (90) 2011 të datës 06.05.2011 të KPMSHCK-së; Vendimin me Nr. 40/III/2012 të datës 29.03.2012 për ekzekutimin e Vendimit A 02 (90) 2011 të datës 06.05.2011 të KPMSHCK-së; Vendimin me Nr. 70/10/2015 të datës 30.10.2015 të Sekretarit të Përgjithshëm të MSH-së; Vendimin A/02/30/2016 të datës të datës 07.03.2016 të KPMSHCK-së; Vendimin A.nr.1831/2024 dhe Vendimin A.nr.1860/2024 të KPMSHCK-së

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur që çështja duhet të kthehet në rishqyrtim të organi njëjtë, *për shkak se:*

Nga provat e lëndës del së ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe së i njëjti sipas Aktit të Emërimit të datës 26.11.2013, ka ushtruar pozitën e punës Zyrtar i Prokurimit, Divizioni i Prokurimit.

Tutje, më Vendimin Nr.122/2024, të datës 28.06.2024, të Qeverisë së Republikës së Kosovës është miratuar Rregullorja (ZKM) Nr.15/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Shëndetësisë, ku Divizioni i Prokurimit është paraparë si njësi më këtë rregullore, mirëpo, që ka pas shkurtime të vendeve të punës për pozitën e zyrtarit të

prokurimit nga katër vende në dy vende. Rrjedhimisht, në kuadër të përgjegjësiave ligjore, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin me Nr.1827/2024, të datës 23.08.2024, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Ministrinë e Shëndetësisë, ku ky i fundit, më datë 04.11.2024, ka miratuar Raportin përfundimtar lidhur me procesin e ristrukturimit në Ministrinë e Shëndetësisë, ashtu që, zyrtarët E.U, këtu ankuesi dhe E.G, janë rekomanduar të sistemohen në pozitën e zyrtarit të lartë të prokurimit, ndërsa, dy nëpunësit civilë të tjerë që kanë mbajtur pozitë Zyrtar i Prokurimit respektivisht A.Th. dhe B.B. janë transferuar në pozitën *Zyrtar i Lartë për Cilësi të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor* përkatësisht *Zyrtar i Lartë për Akreditim të Institucioneve Shëndetësore*.

Tutje, zyrtarët A.Th dhe B.B të pakënaqur me sistemimin e tyre, kanë ushtruar ankesë në Këshill, ndërsa, ky i fundit, përmes Vendimeve A.nr.1860/2024 dhe A.nr.1831/2024, ka aprovuar ankesat e palëve ankuese, ka anuluar aktet administrative lidhur me transferimin e tyre, duke obliguar Komisionin e Ristrukturimit në Ministrinë e Shëndetësisë, që të bëjë rishqyrtimin e sistemit të ankuesve, në atë mënyrë që procesi i ristrukturimit për pozitën Zyrtar i Lartë i Prokurimit duhet t'i nënshtrohet procesit të pikëzimit sikurse përcaktohet më dispozitat ligjore në fuqi.

Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Shëndetësisë duke vepruar sipas vendimeve të Këshillit A.nr.1860/2024 dhe A.nr.1831/2024, më datë 27.02.2025, ka nxjerr raportin më numër 171 duke plotësuar dhe ndryshuar raportin e datës 04.11.2024, ashtu që nëpunësi A.Th. dhe B.B janë propozuar të sistemohen në pozitën Zyrtar i Lartë i Prokurimit, ankuesi është propozuar të transferohet në pozitën Zyrtar i Lartë për Shpenzime, ndërsa, nëpunësja E.G është propozuar të transferohet në pozitën Zyrtare e Lartë për Buxhet. Si rrjedhojë e këtij raporti Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë më datë 28.02.2025, më Vendimin Nr. R.MSH 15/2024/2, ankuesin e ka transferuar nga pozita Zyrtar i Prokurimit në pozitën Zyrtar i Lartë për Shpenzime.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Vendimin me Nr.R.MSH 15/2024/2, të datës 28.02.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, duke pretenduar së vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Shton së Komisioni i Ristrukturimit në kundërshtim me provat materiale dhe me dispozitat ligjore në fuqi ka bërë pikëzimin e kandidatëve, gjegjësisht në mënyrë të padrejtë ankuesin e ka pikëzuar në mënyrë të gabueshme sepse nuk është llogaritur në mënyrë të drejtë përvoja e punës e ankuesit në fushën e prokurimit, nuk janë marr për bazë në mënyrë të drejtë vlerësimet e rezultateve në punë dhe po ashtu edhe trajnimet nuk janë marr për bazë në mënyrë të drejtë, sepse Komisioni i Ristrukturimit ka paraqitur në vlerësim 8 trajnime ndërsa vetë organi i punësimit ankuesit i ka dërguar 10 sosh. Konsideron që ka plotësuar kushtet dhe po ashtu edhe pikët në pikëzim që të transferohet në pozitën Zyrtar i Lartë i Prokurimit, për rrjedhojë kërkon që ankesa të aprovohet si e bazuar, të anulohet akti i kundërshtuara me ankesë dhe pikë I numrin rendor 1 dhe 2 dhe pika II me numrin rendor 2 e plotësim raportit të Komisionit të Ristrukturimit, të vërtetohet se i njëjtë ka 63 pikë sipas procedurës së pikëzimit dhe të detyrohet organi i punësimit që të transferoj/kthej në pozitën Zyrtar i Lartë i Prokurimit.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me të drejtën e tij të sistemimit për shkak të riorganizimit, Kolegji i Këshillit, iu referua dispozitave të nenit 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: 1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunëse/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i

shuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësja/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunëse/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunëses/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësja/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsye të parashikuara në paragrafin 3. të nenit 63 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përbën shkak për lirimin nga shërbimi civil. 6. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësia përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësues të institucioneve të parashikuara në nën-paragrafët 2.1., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës...

Po ashtu, Kolegji për vendosje të drejtë dhe meritore iu referuar edhe Rregullores (QRK) NR. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë respektivisht nenit 13 paragrafi 7, ku përcaktohet: “7. Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve për shkak të ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kriterë: 7.1. përvojën e nëpunësit në shërbimin civil; 7.2. mesataren e vlerësimeve të rezultateve në punë të nëpunësit për tre (3) vitet e fundit; 7.3. kualifikimet profesionale të nëpunësit; dhe 7.4. trajnimet e nëpunësit”.

Andaj, duke u bazuar në kuadrin ligjor si me lartë Kolegji ka analizuar provat materiale të çështjes në ndërlidhje me pretendimet ankimore, si rrjedhojë ka konstatuar së procesi i transferimit për shkak të ristrukturimit lidhur me pozitën e Zyrtarit të Lart të Prokurimit ishte bërë sipas vlerësimit të pikëzimit, ashtu që: zyrtari i prokurimit A.Th, lidhur më përvojën e punës në shërbimin civil është vlerësuar më 43.4 pikë, për mesataren e vlerësimeve të rezultateve në punë për tri vitet e fundit është vlerësuar më 2 pikë dhe për kualifikimet profesionale dhe trajnimet është vlerësuar me 13.5 pikë apo me gjithsej 58.9 pikë. Zyrtari B.B. për përvojën në shërbimin civil është vlerësuar më 49.5 pikë, për mesataren e vlerësimeve të rezultateve në punë për tri vitet e fundit është vlerësuar më 1.5 pikë dhe për kualifikimet profesionale dhe trajnimet është vlerësuar me 9 pikë apo me gjithsej 60 pikë. Zyrtari këtu ankuesi E.U. për përvojën në shërbimin civil është vlerësuar më 29.5 pikë, për mesataren e vlerësimeve të rezultateve në punë për tri vitet e fundit është vlerësuar më 3 pikë dhe për kualifikimet profesionale dhe trajnimet është vlerësuar më 9.5 pikë apo me gjithsej 42 pikë. Zyrtarja E.G. për përvojën në shërbimin civil është vlerësuar më 38.32 pikë, për mesataren e vlerësimeve të rezultateve në punë për tri vitet e fundit është vlerësuar me 3 pikë dhe për kualifikimet profesionale dhe trajnimet është vlerësuar më 13 pikë apo me gjithsej 54.32 pikë, vlerësim ky që ishte bazuar në Udhëzuesin Nr.02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit, i miratuar sipas Vendimit me Nr. 705/2022 të datës 29.04.2022 të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Sipas rregullave të pikëzimit të përcaktuar sipas udhëzuesit të cekur si më lartë, Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar dosjet e të katër kandidatëve që kanë qenë pjesë e pikëzimit, duke marr për bazë si moment të vlerësimit datën 04.11.2024 (raport i parë i ristrukturimit), dhe si pasojë e analizimit ka gjetur së Komisioni i Ristrukturimit nuk ka dhënë vlerësim të drejtë lidhur me kriterin e përvojës së punës, rrjedhimisht, Kolegji ka gjetur së nëpunësi civil A.Th. sipas Kontratës së marrëdhënies së punës me numër kontratës MSH641/09 i njëjti nga data 04.05.2009 deri më datë 28.12.2010, ka mbajtur pozitën Asistent Administrativ (1.7 vite), nga data 28.12.2010 (sipas vendimit nr.05-5921, të datës 28.12.2010, për transferim të përhershme), deri në procesin e ristrukturimi ka ushtruar pozitën Zyrtar i Prokurimit (13.9 vite). Nëpunësi civil Besim Bajraktari sipas Kontratës së

Marrëdhënies së punës MSH558/08 të datës 01.04.2008, është emëruar Zyrtar i Prokurimit në Departamentin e Prokurimit, pozitë të cilën ka vazhduar të ushtroj deri në ristrukturim, pra përvoja e punës në këtë pozitë është 16.7 vjet, e jo 16.5 siç është vlerësuar nga Komisioni i Ristrukturimit. Nëpunësi E.U -ankuesi sipas Kontratës së marrëdhënies së punës me numër të kontratës MSH 666/10, të datës 13.05.2010, është emëruar me datë 13.05.2010 në pozitën Zyrtar i Kontabilitetit, e të cilën pozitë e ka ushtuar deri më 27.04.2017 (6.9), mirëpo, në këtë periudhën kohore prej datës 01.10.2011 deri më datë 31.12.2011 ka qenë i caktuar Zyrtar i Prokurimit sipas Vendimit 05-4334 të datës 26.09.2011 (3 muaj), fakt ky që nuk ishte marrë parasysh nga Komisioni i Ristrukturimit, ndërsa, nga data 27.04.2017, i njëjti sipas Vendimit nr.02/05-3171, të datës 27.04.2017, është transferuar në mënyrë të përhershme duke ushtuar pozitën Zyrtar i Prokurimit deri në ristrukturim, pra përvoja e punës si zyrtar i prokurimit është 7.8 vite e jo 7.5, siç ishte vlerësuar nga Komisioni i Ristrukturimit. Nëpunësja E.G sipas Kontratës së Marrëdhënies së Punës me numër të kontratës 3/2007, të datës 13.04.2006 është emëruar në pozitën Asistente Administrative në Departamentin për Menaxhim të Emergjencave, pozitë të cilën e ka ushtuar deri më datë 25.03.2008 (2 vite), sipas kontratës së marrëdhënies së punës me numër të kontratës MSH 557/08, të datës 25.03.2008, e njëjta deri më datë 26.02.2020 ka mbajtur pozitën Asistente e Prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë (11.11 vite), ndërsa, nga data 27.02.2020 deri në ristrukturim ka mbajtur pozitën Zyrtare e Prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë, pra 4.8 vite e jo 4, 7 vite, siç është vlerësuar nga Komisioni i Ristrukturimit.

Kolegji i Këshillit vlerëson se procesi i vlerësimit sipas pikëzimit sa i përket përvojës së punës në shërbimin civil është vlerësim jo i drejtë dhe diskriminues dhe si të tillë Kolegji nuk ja fali besimin, sepse, përvoja e punës si asistent administrativ është vlerësuar si përvojë e ngjashme të zyrtarja E.G, duke u vlerësuar më nga 2 pikë për çdo vit përvojë pune, ndërsa, të zyrtari A.Th, është vlerësuar si përvojë në shërbim civil duke u vlerësuar më nga 1 pikë për çdo vit përvojë pune. Në ndërlidhje me këtë konstatim Kolegji i Këshillit rikujton sqarimin e dhënë në Udhëzuesin Nr.02/2022, shtojca nr. 1, pika 4, nënpika 4.2 dhe 4.3 ku thuhet se: *Përvojës së punës në pozita të ngjashme në shërbimin civil me pozitën për të cilin po gjykohet. Me pozita të ngjashme kuptohen pozitat e punës me përshkrimin të përafërt dhe me arsimin të ngjashëm, (p.sh. pozita për të cilën po gjykohet është “Drejtore e Departamentit të Kërkimit Shkencor” në Ministrinë e Arsimit; pozita e ngjashme është “Drejtore për Arsimin e Lartë” në të njëjtën Ministri); 4.3 Përvojës së punës në pozitën për të cilën po gjykohet, apo në pozita të njëjta të shërbimit civil me atë për të cilin po gjykohet. Këto pozita kanë përshkrim të njëjtë pune, (p.sh. pozita për të cilën po gjykohet është “Drejtore e Departamentit të Financave” në Ministrinë e Brendshme; pozita e njëjtë është “Drejtore e Departamentit të Financave” në secilën prej Ministrive).* Kështu që ,në vlerësimin e Kolegjit përvoja e punës si asistent administrativ konsiderohet si përvojë në shërbim civil jo si përvojë e ngjashme.

Lidhur me kriterin e vlerësimi të rezultateve në punë, Kolegji i Këshillit nga analizimi i prova të lëndës ka konstatuar së zyrtari A.Th. në vitin në vitin 2021, ka qenë i vlerësuar me notë të përgjithshme 3.8, në vitin 2022, ka qenë i vlerësuar me notë të përgjithshme 3, ndërsa ,në vitin 2023, ka pasur vlerësim të përgjithshëm me notë 2, ndërsa, Komisioni i Ristrukturimit ka dhënë konstatim të gabuar lidhur me vitin 2023, pasi që ankuesi ka notë të përgjithshme 2 dhe vlerësimi duhet të ishte 0 pikë, kurse, Komisioni i Ristrukturimit ka evidentuar note 3 të vlerësimit duke i dhënë 0.5 pikë.

Përkitazi më pretendimin e ankimor të ankuesit lidhur me mënyrën e vlerësimit të kriterit të trajnimeve, Kolegji nga analizimi i Raportit të Komisionit të Ristrukturimit, ka evidentuar vlerësim jo të drejt dhe diskriminues, ashtu që, ankuesi posedon Certifikatat e lëshuar nga USAID lidhur me workshopin e vitit 2022, me temën” Build the capacities of the institucion oficiale for utilization of MEAT criteria” dhe Certifikatën e lëshuar nga USAID 2022 me temën “ Training for focus institutions officialts in intergrity disklosure and managment of conflict ose interes”, ndërsa, Komisioni i Ristrukturimit në mënyrë krejt diskriminuese trajnimin e njëjtë më temën “Build the capacities of the institucion oficiale for utilization of MEAT criteria-USAID, e ka njohur si kualifikim profesional të veçantë tek zyrtari A.Th dhe B.B, duke dhënë nga 0.5 pikë të vlerësimit, ndërsa, trajnimi i njëjtë nuk është marrë për bazë për vlerësim si trajnim i veçantë tek ankuesi dhe zyrtarja E.G, po vlerësohet te trajnimet tjera.

Në kontekst të vlerësimit sipas pikëzimit lidhur me kriterin e trajnimeve dhe kualifikimeve profesionale, Kolegji i Këshillit ka vërtetuar së Komisioni i Ristrukturimit trajnimin me temën” Moduli i blerjeve, urdhër blerjeve SIMFK” e kishte vlerësuar si trajnim specifik të zyrtari B.B duke vlerësuar me 0.5 pikë, ndërsa trajnimin e njëjtë nuk e kishte vlerësuar si trajnim specifik të ankuesi. Kurse trajnimin referuar Office (Word, Exel...) e kishte njohur si trajnim të veçantë tek zyrtari A.Th., duke i dhënë 1 pikë të vlerësimit, ndërsa, trajnimin e njëjtë nuk e ka vlerësuar si trajnim i veçantë tek zyrtarja E.G. Po ashtu, ankuesi posedon Certifikatën, e datës 25.02.2017, për pjesëmarrje në trajnim “Menaxhimi dhe Kontrolli Financiar, Roli dhe Rëndësi e E-prokurimit” e të cilin trajnim Komisioni i Ristrukturimit nuk e ka vlerësuar si trajnim nga fusha e pozitës, ndërsa, ndryshe kishte vepruar tek zyrtarja E.G., ku te njëjtës trajnimin e njëjtë e ka njohur si trajnim specifik të fushës së pozitës.

Bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si me sipër, Kolegji erdhi në përfundimin së Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Shëndetësisë nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike lidhur më vlerësimin dhe pikëzimin e kriterëve të vlerësimit në procesin e ristrukturimit për pozitën Zyrtar i Lart i Prokurimit, dhe mbi këtë bazë, Komisioni i Ristrukturimit, ka vepruar në kundërshtim me nenin 66 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 12, 13 dhe 14 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, andaj, mbështetur në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1. 2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht, aprovoj ankesën si të bazuar, anuloi pikën I dhe nën pikën 2 dhe 3 të pikës II të Raportit më numër protokolli 171, të datës 27.02.2025, të Komisionit të Ristrukturimit në Ministrinë e Shëndetësisë si dhe çdo veprim tjetër administrativ që rrjedhë nga pjesa e anuluar e Raportit të datës 27.02.2025, ndërsa, çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivlerësim të organi i njëjtë, me detyrimin qe ky i fundit në ri-procedurë, e në pajtim më pikëpamjet ligjore të dhëna në arsyetim të këtij vendim, të rivlerësoj transferimin dhe sistemin e pozitës së zyrtari të lart të prokurimit, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe në zbatim të plotë dhe të drejtë të ligjit material.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.556/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit, Avokat Shkodran Manaj;
- Organit të punësimi: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore,
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në MPB dhe Komisionit të Ristrukturimit);
- Arkivit të KPMSHCK-së.